

## MBI HISTORINË E PARRËFYER DETARE TË SHQIPTARËVE

Edhe pse jemi një nga popujt që kemi jetuar në brigjet e Mesdheut për mijëra vite, jemi ndoshta të vetmit mesdhetarë që pothuajse nuk i kemi lëvruar studimet e historisë detare. Duket në fakt e pabesueshme se sa pak studime mbi detin janë ndërmarrë nga shkenca shqiptare në përgjithësi dhe nga ajo historike në veçanti.<sup>1</sup> Megjithëse shqiptarët janë një popull mesdhetar që gëzon një pozitë strategjike kyçe në Mesdheun Qendror, duke dalë në dy nga detet më të rëndësishme të këtij deti të madh, kanë pasur një rol të kufizuar në historinë detare të mesjetës. Kjo mangësi është parë nga kundërshtarët e tezës së autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre të lashta si fakt i pakundërshtueshëm që dëshmon se shqiptarët janë formuar si komb në një zonë tjetër larg ndikimit të detit. Një nga argumentet më të përdorura nga mohuesit e autoktonisë së shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor dhe rrjedhimisht mohuesit e vazhdimësisë iliro-shqiptare janë lidhjet e pakta të shqiptarëve me detin, qoftë në aspektin historik ashtu edhe në atë gjuhësor.<sup>2</sup> Padyshim që ky supozim është

---

<sup>1</sup> Edhe ato vepra që e kanë rrokur nga këndvështrimi etnografik apo gjuhësor janë modeste për të shërbyer si bazë për studime të mirëfillta. I tillë është punimi i Rrok Zojzit, *Traditat e lundrimit detar të popullit shqiptar* (Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, 1959), 50 f. Nevoja e studimeve të tilla bëhet edhe më e madhe, po të kihet parasysh se deti është një nga atraksionet më të mëdha turistike dhe kur dihet lidhja mes turizimit dhe zhvillimit ekonomik. Adnan Muslija, Elma Šatrović, Cansu Unver Erbas, Saliha Cabro, "The Relationship between Tourism and Economic Growth: A Panel Granger Causality Method" in *9th International Conference of the School of Economics and Business* (Sarajevo, 2018), f. 236-245; Po ashtu shih edhe Elma Šatrović, Ensar Šehić, "Causality Relationship between Foreign Direct Investment and Tourism," in *International Tourism and Hospitality Management Conference, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina. 30 September - 4 October 2015* (Sarajevo: Faculty of Science, University of Sarajevo, 2016), f. 474-483.

<sup>2</sup> Gustav Weigand, "Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrer oder der Traken", *Balkan Archiv* 3 (1927): 227-251. Tezë e mbështetur nga Petar Skok,

spekulativ, jo sepse nuk mbështetet në fakte, por për arsye se e shtjellon çështjen vetëm deri aty sa justifikon këtë pretendim, duke mos i shtjelluar të gjitha faktet dhe faktorët e një mangësie të tillë. Këta autorë duke parë natyrën e leksikut detar të shqipes, që sipas tyre nuk përmban fjalë detare të vetat në numër të madh, pohojnë se shqipja nuk është gjuhë me prejardhje ilire, por trake, pasi i ka marrë këto fjalë të leksikut detar nga gjuhët fqinje.<sup>3</sup>

Mendimi i autorëve që mbështesin tezën se shqiptarët duhet të kenë mbërritur në brigjet e Mesdheut më vonë se sa popujt e tjerë ballkanikë, për shkak të leksikut të kufizuar që gjuha shqipe ka të lidhur me detin, duhet marrë me shumë rezerva. Shqiptarët janë të pranishëm në historinë detare jo vetëm të Mesdheut, por edhe të Atlantikut dhe të Evropës Veriore që në mesjetën e vonë, madje duhet thënë se në të njëjtën kohë me popullsi të tjera, të konsideruara si me traditë detare. Bashkëveprimi i kufizuar i shqiptarëve me detin e tyre në mesjetë është plotësisht i kuptueshëm dhe i shpjgueshëm. Nga të dy detet që lagin brigjet

Vladimir Georgiev, etj. Henry H. Kahane, "The Sea as a Medium of Linguistic Diffusion," *Italica* 28/4 (1951): 289, shprehet: "Languages like Albanian or Roumanian give nothing but take much by means of the sea". Ideja del më e qartë tek autorë sllavë, p. sh. Ivan Popović, "Balkanlateinisches Á im Südslavischen und Albanischen," *Zeitschrift für Romanische Philologie* 76 (1960): 228-229: "die Südslaven ältere Einwohner der Mittelmeerküste sind als die Albaner... ganz Albanien einst nicht albanisches, sondern slavisches Land war." Ky argument madje ka gjetur shprehjen e vet edhe në forumet e rëndësishme shkencore albanologjike. Giuliano Bonfante, "Shqipja dhe ilirishtja", në *Kuvendi i Parë i Studimeve Ilire, Tiranë 15-20 shtator 1972*, vëll. II (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSH-së, 1974), 104, pohon "shqiptarët nuk janë autoktonë në Shqipëri... E gjithë terminologjia detare dhe e peshkimit (duke përfshirë peshk "pesce") është në gjuhën shqipe me origjinë latine ose venedikase, ose italiane ose sllave. Dhe në të vërtetë shqiptarët janë një popull barinjsh, kontinentalë, që nuk është i mësuar me detin". Nga ana tjetër, kjo tezë është kundërshtuar nga Eqrem Çabej, "Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve", *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, 12 (1958): 54-66. W. Cimohowski, "Prejardhja e gjuhës shqipe", *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, 12 (1958): 36-53; Cătălina Vătăşescu, "Dénominations latins de poissons en albanais. Comparaison avec le roumain," *Revue des études sud-est européennes* 33/1-2 (1995):189. Nga ana e tij Lirak Dodbiba, "Leksiku detar i shqipes dhe etnogjeneza e popullit tone," në *Kuvendi i Parë i Studimeve Ilire*, f. 102, kundërshton mbështetësit e kësaj teze.

<sup>3</sup> Norbert Jokl, "Albaner, Sprache," në *Reallexikon der Vorgeschichte*, herausgegeben von M. Ebert, Band. I, (Berlin: 1924): 32; Weigand, "Sind die Albaner," 227-251.

shqiptare, padyshim që Adriatiku ka rëndësinë më të madhe. Për të kuptuar raportet e popullsive që ndajnë brigjet e këtij deti me të, duhet konsideruar historia e luftës për dominimin e tij. Gjatë shekujve të mesjetës, veçanërisht ndërmjet shekujve XIII-XV, ky det shndërrohet në një “gji” venedikas.<sup>4</sup> Mbizotërimi i Venedikut në këtë hapësirë detare merr përmasat e një monopoli deri në atë pikë sa që Venediku e konsideron Adriatikon si det i brendshëm të vetin, duke pretenduar të drejtën ekskluzive të lundrimit në det të hapur.<sup>5</sup> Ky monopolizim i hapësirës detare adriatikase kufizonte marrëdhëniet dhe bashkëveprimin me detin jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të popujve dhe njësive të tjera politike që gjeografikisht ndanin brigjet e këtij deti. E ilustron këtë fakt më së miri rasti i Raguzës, që edhe pse ishte themeluar si port dhe që bazën e vet ekonomike e kishte të lidhur kryekëput me shfrytëzimin e detit, nuk arriti të zhvillojë potencialin e vet detar deri në fundin e shekullit XIV, kur vihet nën suzerenitetin e kurorës hungareze, duke gjetur në këtë mënyrë mburojën e jashtme ndaj politikës ekskluziviste (përrjashtuese) venedikase.<sup>6</sup> Raguzë njohu që prej kësaj kohe e deri në shekullin XVII periudhën e vet të artë, duke u shndërruar në një nga qytetet më të pasura dhe të zhvilluara të Mesdheut.<sup>7</sup> Akoma më të qartë e bën këtë rasti i Ankonës që

---

<sup>4</sup> Mes Vlorës dhe S. Maria di Leuca në Pulja kalon vija imagjinare që shënonte kufirin e «Gjirit të Venedikut». Për herë të parë ky term del në shek. X te një autor arab, Ibn Haëqal, *ğûn al-banâdiqîn*. Edhe osmanët e vazhduan traditën duke e quajtur *Venedik Körfezi*. Maria Pia Pedani, “Gli ottomani in Adriatico tra pirateria e commercio”, në *I Turchi, gli Asburgo e l’Adriatico*, a cura di Gizella Nemeth e Adriano Papo, (Duino Aurisina: Associazione culturale italoungherese Pier Paolo Vergerio, 2007), 57.

<sup>5</sup> Venediku e konsideronte Adriatikon si zonë të vetën të sigurisë, deri aty sa i konsideronte anijet e armatosura që hynin në “gji” si anije korsare. Më 1347-n Senati u përgjigjej të dërguarve të Markes e Fermos se “securitatis maris in quo dicatur quod spectat ad honorem nostrum”. *Venezia-Senato. Deliberazioni miste. Registro XXIV (1347-1349)*, ed. Ermanno Orlando, vëll. 11 (Venezia, 2007) nr. 101, fl. 11v.

<sup>6</sup> Rivaliteti ndërmjet Venedikut dhe Hungarisë për Dalmacinë përfundoi më 1358-n me fitoren e Hungarisë. Zdenka Janeković Romer, *Višegradski ugovor temelj Dubrovačke Republike* (Zagreb, 2003), 64-68; Zrinka Pešorda-Vardić, “The Crown, the King and the City: Dubrovnik, Hungary and the Dynastic Controversy, 1382-1390,” *Dubrovnik Annals* 10 (2006): 9.

<sup>7</sup> Bariša Krekić, “Dubrovnik and Spain: Commercial and Human contacts, fourteenth-sixteenth centuries,” në *Iberia and the Mediterranean World of the*

ishte porti italian më i rëndësishëm që konkurronte Venedikun në Adriatik, që megjithatë e pësoi herët përballë agresivitetit venedikas.<sup>8</sup>

Në rastin e Shqipërisë, monopoli venedikas shtrihej edhe në brigjet më jugore, ato të detit Jon.<sup>9</sup> Veçanërisht gjatë shekullit XV, kur Venediku për herë të parë në historinë e vet si republikë me bazë detare fillon një politikë të re, të zotërimit edhe të territoreve në "terraferma" apo në brendatokë, me ç'rast përfshin në zotërimet e veta edhe një pjesë të rëndësishme të tokave shqiptare,<sup>10</sup> rritet pesha dhe kontributi i detarëve shqiptarë në flotën venedikase. Megjithatë për faktin se Venediku përbënte rastin më tipik të një shteti që mbështetej ekskluzivisht në patriciatin lokal, mundësia e promovimit shoqëror në bazë të meritave profesionale ishte tejet e kufizuar. Ky karakter skajshmërisht i mbyllur i strukturës shoqërore venedikase shtrihej jo thjesht në vetë qytetin e Venecias, por edhe në zotërimet e saj koloniale.<sup>11</sup> Megjithëse Venecia ishte

*Middle Ages, Essays in Honor of Robert I. Burns S. J., vol. II, (Leiden-New York- Köln: E. J. Brill, 1996), 396-397; Francis W. Carter, "The Commerce of the Dubrovnik Republic, 1500-1700," The Economic History Review, 24/1 (1971): 370.*

<sup>8</sup> Tregtia e Ankonës hyri në krizë veçanërisht mbas konfliktit që u mbyll me një marrëveshje nënshtreuese për të, më 1264-n. Rowan W. Dorin, "Adriatic Trade Networks in the Twelfth and Early Thirteenth Centuries", në *Trade and Markets in Byzantium*, ed. Cécile Morrisson (Washington: Dumbarton Oaks Research Library, 2012), 210, 267; Megjithatë që në fillimin e shek. XVI hegjemonia venedikase në Adriatik dhe më tej po venitej. J. Dotson, "Foundations of Venetian Naval Strategy from Pietro II Orselo to the Battle of Zonchio," *Viator*, 32 (2001): 125.

<sup>9</sup> Korfuzi ishte pika strategjike që dominonte hyrjen e Adriatikut. Venediku e mori më 1386-n dhe e mbajti deri në fundin e Republikës më 1797-n. Dorin, "Adriatic Trade Networks," 265.

<sup>10</sup> Përveç qyteteve shqiptare të Durrësit, Lezhës, Shkodrës, Drishtit, Ulqinit e Tivarit, në Itali mori Trevison (1387), Padovan (1405), Veronën (1402), Vicenzan (1404), Bellunon (1420), Brescian (1426), Bergamon (1428), Creman (1454), Lago Gardan (1441), Rovereton (1416). Në Egje mori Nauplian (1388), Lepanton (1393), Argos (1394), Patras (1408), Selanikun (1423). J. Law, "The Venetian Mainland State in the Fifteenth Century," *Transactions of the Royal Historical Society* 6th series, II (1992): 153-174; Oliver Jens Schmitt, "Le commerce vénitien dans l'Albanie vénitienne: mécanismes et conjonctures d'un espace économique au XV<sup>e</sup> siècle," *Anuario de estudios medievales* 33/2 (2003): 881-883, mendon se zgjerimi i pushtetit venedikas në tokat shqiptare ishte e lidhur pikësisht me arsye strategjike.

<sup>11</sup> Schmitt, "Le commerce vénitien," 885 pohon se tipi i tregtarit në tokat shqiptare

një qytet kozmopolit, lëvizshmëria shoqërore ishte e ngurtësuar si askund tjetër. Kjo e shpjegon edhe faktin që edhe detarë të shquar e me përvojë të madhe, në Venedik nuk kishin mundësi që të arrinin promovimin shoqëror dhe profesional siç ndodhte në shtetet e tjera të Evropës<sup>12</sup>.

Autoktonia mohohet jo vetëm me hipotezën e imigrimeve trake, por edhe me natyrën e leksikut tonë detar, për shkak të mungesës së fjalëve shqipe dhe mbizotërimit të fjalëve me prejardhje të huaj, kryesisht nga italishtja. Duke kujtuar studimet e E. Çabejt dhe të V. Cimochowskit mbi këtë çështje nuk ka asnjë arsye të mos besohet se shqiptarët janë autoktonë në viset ku banojnë sot.<sup>13</sup> Leksiku detar i shqipes është një përshtatje e fondit të leksikut të përgjithshëm për nevojat e veprimtarisë detare. Ato pjesë të leksikut detar që kanë karakter kuptimor të përgjithshëm dhe jo ngushtësisht profesional, kanë shumë fjalë shqipe me përshtatje për veprimtarinë detare. Përkundrazi ato pjesë të leksikut që kanë karakter ngushtësisht zejtar, me pak përjashtime, janë fjalë kryesisht me prejardhje të huaj, dhe nuk i përkasin në përgjithësi fondit të leksikut të shqipes. Nga fjalët me karakter jo ngushtësisht zejtar prej rreth 50 fjalësh, më se gjysma janë të fondit

---

“était toujours un patricien, car la République de Saint-Marc réservait à la classe aristocratique le droit exclusif de gérer l’administration dans l’État vénitien”. Freddy Thiriet, *Histoire de Venise* (Paris: Presses Universitaires de France 1976), 45, thotë: “Les charges supérieures sont réservés aux patriciens vénitiens”.

<sup>12</sup> Një rast që e ilustron këtë është ai i Mikelit nga Rodi që me qëllim promovimin e tij në karrierën detare shkroi një vepër meritorë mbi detarinë dhe ndërtimin e anijeve, megjithatë nuk ia arriti të ngrihej në detyrë. Ngjashëm me të edhe trashëgimtari i dorëshkrimit të tij Gjoni nga Drishti ishte vetëm “padrone giurato” (apo mbikëqyrës i një numri të rremëtarëve) i pronarit Marino Dandolo në kohën kur harton testamentin e tij më 1473. Pamela O. Long, “Introduction: The World of Michael of Rhodes, Venetian Mariner”, në *The Book of Michael of Rhodes. A Fifteenth-Century Maritime Manuscript*. Edited by Pamela O. Long, David McGee, and Alan M. Stahl, Vol. 3. (Massachusetts-London: The MIT Press, 2009), 1-2.

<sup>13</sup> Eqrem Çabej, “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve,” *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore* 2 (1958): 54-62; Eqrem Çabej, “Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve,” *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore* 1 (1962): 210-226; Waclaw Cimochowski, “Prejardhja e gjuhës shqipe,” *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore* 2 (1958): 37-48.

të leksikut të përgjithshëm, si: det, thellësirë, ujna, ujëra, breg, buzë, grykë, gur, ngushticë, bisht, shkëmb, shpellë, kënetë, valë, gj, sop, zhur, ranë, rërë, etj. Me karakter më pak të përgjithshëm, pra me kuptim më special është një shtresë fjalësh të huaja, me origjinë nga gjuhët romane ose nga venecianishtja, si: kanal, bati, baticë, zbaticë, marzhi, port, porta, mol, radë, mandraq etj; me origjinë turke fjalët: liman, gjol, batak, skelë, dallgë, tallaz, me origjinë greke: skalomë, kserë e ndonjë tjetër. Tipet e anijeve kanë emra të huaj që kanë hyrë në gjuhën shqipe me ndërmjetësinë e të folmeve italiane e sidomos të venecianishtes. Këta emra i gjejmë në të gjitha gjuhët e Mesdheut, si: nave, lundër, brik, brigëntinë, beshtje, trabakull, bragoc, kotër, skunë etj. Nga turqishtja, ose me ndërmjetësinë e saj, kemi: kaike, sanall, maunë, fëllukë. Po ashtu edhe pjesë të anijes, si: dyrek, bash e kiç.<sup>14</sup>

Të gjitha terminologjitë detare mesdhetare, edhe ato të të folmeve bregdetare italiane, kanë dalë nga ripunimi i leksikut bazë me origjinë tokësore, me lidhje shumë të dobëta me elemente leksikore detare të lashta. Romakët, bashkë me sundimin politik, iu imponuan ilirëve si gjuhën dhe kulturën e tyre, ashtu dhe teknikën e tyre detare. I shpëtuan ndikimit direkt dhe asimilimit të plotë vetëm disa vende të vogla detare dhe viset malore. Ky largim nga qytetet detare dhe mbijetesa në vende malore, e ruajti gjuhën, por jo leksikun detar. Vetë italishtja ka trashëguar shumë pak terma detare nga gjuha nënë, latinishtja. Me fuqizimin e republikave detare të Gjenovës dhe të Venedikut, leksiku detar i të folmeve italiane u riformua me fjalë të gjuhës popullore. Perandoria Bizantine mbijetoi deri në fundin e mesjetës, por është domethënës fakti që edhe pse grekët e lashtë i dhanë latinishtes dy të tretat e fjalëve detare<sup>15</sup> greqishtja e re për habi është ndikuar shumë prej të folmeve detare italiane, sidomos asaj veneciane.<sup>16</sup> Duket pra, se në përgjithësi leksikët detarë të gjuhëve mesdhetare kanë pak lidhje me antikitetin. Leksiku detar i tyre është formuar

<sup>14</sup> Lirak Dodbiba, "Leksiku Detar i Shqipes dhe Etnogjeneza e Popullit Tonë," në *Kuendit I i Studimeve Ilire: Tiranë 15-20 shtator 1972*, (Tiranë: 1974).

<sup>15</sup> Manlio Cortelazzo, "I termini ereditati e la componente terrestre nel lessico nautico italiano," *Bollettino dell'Atlante linguistico mediterraneo* 8-9 (1966/67): 67-77.

<sup>16</sup> A. Karanastasis, "L'estensione dell'influsso veneziano sulla terminologia marinaresca greca," *Bollettino dell'Atlante linguistico mediterraneo* 8-9 (1966/67): 173-183.

në agimin e rilindjes së qytetërimit, pas dyndjes së popujve, aty nga fillimi i shekujve X, XI, kur po kryhej kristalizimi i gjuhëve të reja romane, në bazë të të folmeve popullore më fort me prejardhje tokësore, nga bujqësia dhe zejtaria. Pra, leksiku i sotëm detar i shqipes është formuar në kohë të reja, pak a shumë po në atë kohë që u formuan edhe leksikët detarë të të folmeve të tjera mesdhetare me bazë të folmet popullore.

Po ashtu, edhe në rrafshin e dokumentimit historik, shqiptarët janë të pranishëm në historinë detare, jo vetëm të Mesdheut, por edhe të Atlantikut dhe të Evropës Veriore që në mesjetën e vonë, madje duhet thënë se në të njëjtën kohë me popullsi të tjera, të konsideruara si me traditë detare. Nëse autorë të huaj kanë mbështetur idenë se qytete porte të bregut shqiptar në mesjetën e hershme, si Durrësi, Vlora apo Ulqini kishin një mbizotërim të popullsisë së asimiluar greko-latine, për raste si Kepi i Rodonit mbetet krejt e sigurtë se bëhet fjalë për shqiptarë të paasimiluar.<sup>17</sup> Të dhënat mbi Rodonin në përgjithësi janë të kursyera. Ky kep kishte një pozitë shumë të mirë për të kapur karvanet tregtare që vinin nga Dalmacia. Kjo shpjegon edhe arsyen përse në fillim ai del në histori si një strofkë piratësh. Anijet raguzane u sulmuan dy herë nga banorët e Rodonit, njëherë më 23 janar 1324 dhe herën e dytë më 9 mars 1335. Dihet se këta vepronin, të paktën më 1355-n, për llogari të Karl Topisë.<sup>18</sup>

Shqiptarët janë një popull mesdhetar, jo thjesht pse Shqipëria ka një pozicion shumë strategjik në breg të Adriatikut dhe Jonit, por edhe për shkak të historisë. Nga shekulli XV deti Adriatik nuk do të jetë më një det i dominuar ekskluzivisht nga venedikasit. Ndikimi hungarez në Dalmaci dhe prania osmane në Shqipëri, përfundimisht i dhanë fund monopolizimit të lundrimit në detin Adriatik nga Venecia. Edhe e ashtuquajtura politikë lindore e Alfonsit V të Napolit është në thelb një përpjekje për të sfiduar dominimin venedikas në Adriatik. Më të fituarit nga kjo situatë e re që do të zgjaste për 4 shekuj ishin kroatët dhe shqiptarët, por edhe ankonitanët në bregun italian. Rritja e trafikut në

<sup>17</sup>Alain Ducellier, "Gjendja e kepit të Rodonit në fillim të shek. XV sipas disa dokumenteve raguzane," *Studime historike* 1 (1977): 123-132.

<sup>18</sup> *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, collegerunt et digesserunt Ludovicus de Thallóczy, Constantinus Jireček et Emilianus de Šufflay, volumen I (Vjenë: Adolphi Holzhausen, 1913), nr. 694.

Adriatik i dha hov ekonomisë së bregut lindor të Adriatikut dhe bashkëveprimi i shqiptarëve me detin dhe botën mesdhetare arriti zhvillimin më të madh në krejt historinë tone, pikërisht në shekujt qendrorë të periudhës osmane, pra në shek. XVI-XVIII, kur edhe Adriatiku u shndërrua nga një “liqen” apo “gji” venedikas në një det të shfrytëzuar nga aktorë të ndryshëm, si kroatët, shqiptarët, spanjollët, përveç venedikasve.

Situata e re e krijuar nga ndryshimi i raportit të forcave në Adriatik pasqyrohet nga dokumentacioni që nga vitet '80 të shek. XV, kur Vlora filloi të shndërrohet në një nga qendrat më të rëndësishme detare të Adriatikut dhe padyshim porti më i rëndësishëm adriatikas nën sundimin osman. Rol të rëndësishëm në këtë transformim të Vlorës në qendër detarie, padyshim që pati përfundimi i luftës veneto-osmane të viteve 1463-1479, që e shndërroi Venedikun nga fuqi armike në një aleat paqësor për lundrimin shqiptar në Adriatik dhe gjithashtu projekti ambicioz i pashait Ahmed Gedik Pasha që e bëri Vlorën qendrën e grumbullimit të flotës më të madhe të ndërtuar deri atëherë nga shteti osman. Kështu, që në korrik 1486 situata e lundrimit të patrazuar nga venedikasit zë e merr trajtë. Sulltan Bajaziti në një letër drejtuar Doxhës i jep leje Sinjorisë që sikurse është vendosur në artikujt e paqes mes tyre të ndëshkojë korsarët që sulmojnë e fundosin anije venedikase. Gjithashtu, nga kjo letër mësojmë se sulme të tilla u ishin shkaktuar tashmë nga shqiptarët, pasi sulltani urdhëron sanxhakbeun dhe kadijtë e Shqipërisë që të hapnin një proces hetimor dhe të ndëshkonin fajtorët dhe të dëmshpërblenin të dëmtuarit.<sup>19</sup> Dy vite më vonë kemi të dhëna edhe më konkrete mbi këto zhvillime të reja, pasi sërish nga një letër e Bajazitit II për doxhën Agostino Barbarigo mësojmë se venedikasit kishin paraqitur ankesa të bazuara në fakte konkretë mbi dëmet e shkaktuara anijeve të tyre nga disa

---

<sup>19</sup> “Il sultano autorizza la Signoria, come stabilito nelle capitolazioni, a punire i corsari che, contro il suo volere, depredano e affondano navi venete. Invia inoltre la Signoria a mandare un suo agente a presenziare a una inchiesta, ordinata al sangiacco e ai cadì di Albania, per la punizione dei colpevoli e il risarcimento dei danni. I “documenti turchi” dell’ Archivio di Stato di Venezia: inventario della miscellanea. A cura di Maria Pia Pedani Fabris, con l’edizione dei registi di Alessio Bombaci (Venezia: Ministero per i Beni Culturali e Ambientali, 1994), nr. 33, korrik 1486.

fusta të Vlorës dhe për urdhrin e dhënë nga sulltani për kapitenin dhe kadinë e subashin që të ndëshkojnë faktorët dhe të rikthenin mallrat e grabitura.<sup>20</sup> Edhe një dokument i disa viteve më vonë, i datës 8 dhjetor 1502, pavarësisht se nuk bën fjalë për ndonjë sulm korsarësh, por për mbytjen e anijes së venedikasit Nikolo Rezo, së bashku me krejt ekuipazhin dhe vetë Recon, vetëm pak kohë pasi kishte dalë nga porti i Vlorës dëshmon këtë trafik që zhvillohej në Vlorë, edhe në periudhë dimri kur lundrimi synohej të evitohet me çdo kusht.<sup>21</sup> Beteja e Prevezës mund të konsiderohet si pika e kthesës në sfidimin e supremacisë venedikase në Adriatik. Në këtë aspekt, edhe pse përpjekjet e osmanëve për të pushtuar Pulien dhe Korfuzin në 1537-n nuk patën sukses, fitorja osmane mbi forcat aleate të Habsburgëve, Venedikasve, Papatit, dhe Gjenovës, jo vetëm që e shkërmoqi përfundimisht supremacinë venedikase në Adriatik, por vendosi supremacinë detare osmane në Mesdhe.

Nuk duhet harruar se edhe pse pa anijet e tyre, shqiptarët kishin krijuar një përvojë e kontakt të konsiderueshëm me punët e detit, kulturën dhe teknikat e lundrimit. Që në shekullin XIV, edhe pse pa mundur të kenë role drejtuese e funksione të larta në detari, prapë kishte tashmë një traditë lundrimi si rremëtarë dhe detarë të rangut modest në anijet venedikase që përshkonin kryq e tërthor Mesdheun dhe që nga shek. XIV edhe Atlantikun. Fillimi i shekullit XIV shënoi një fazë të re zhvillimi në rritje të qarkullimit detar me krijimin e linjave të lundrimit për galerat tregtare të destinuara për pushtimin e tregjeve perëndimore e lindore. Nga Londra në Damask, tregtarët venedikas kishin mjete lundrimi që ua vuri në dispozicion qeveria. Kushtet e jetesës dhe të punës në kuvertën e një galere ishin vërtet të rënda. Rremëtarët shqiptarë ashtu sikurse kolegët e tyre skiavonë dhe grekë ishin si rregull njerëz të lirë dhe me rrogë. Ata flinin, hanin dhe i manovronin rremat pa lëvizur nga vendi i vozitjes, aq e ngushtë ishte hapësira. Pllakosja e murtajes, pas vitit 1348 i hapi portat një vërshimi masiv punëtorësh migrantë dalmatë, shqiptarë

<sup>20</sup> "in seguito alle rimostranze del bailo a proposito dei anni causati da alcune fuste turche uscite da Valona, il sultano comunica di aver ordinato al capitano di quel luogo di punire i malfattori e ai cadì e *subaşı* di restituire al veneziani ciò che fu loro tolto. (mp). I "documenti turchi," nr. 39, Stamboll, 9 tetor 1488.

<sup>21</sup> Andrea Gritti për Sanxhakbeun [e Vlorës] Mehmet Beun. I "documenti turchi," nr. 67, 8 dhjetor 1502.

dhe grekë. Fuqia detare e Venedikut, që kish rënë në vështirësi gjatë luftës së Kioxhës e pastaj nga humbja e Dalmacisë mbas paqes së Torinos, duhej të kompensonte mungesën e punëtorëve të krahut. Edhe në shekullin XVI rritja e vëllimit tregtar solli si pasojë mungesë të madhe krahësh pune në detari. Shkërmoqja e monopolit venedikas në Adriatik do të lajmërohet që në fund të luftës veneto-osmane të viteve 1463-1479.<sup>22</sup> Më pas, në shek. XVI ky monopol do të marrë fund me penetrimin e flotës spanjolle në jug të Italisë, si edhe me daljen e fuqisë detare të Algjerisë, Tripolit e Tunizisë.<sup>23</sup>

Edhe terminologjia e përdorur për të përshkruar veprimtarinë detare të shqiptarëve në Adriatik, Jon, Egje, në Mesdhe në përgjithësi e përtej tij nuk duhet të na gënjejë dhe duhet marrë e kundruar me syrin kritik. Nga këndvështrimi i relatuesve shqiptarët që ushtronin detari mund të jenë konsideruar si piratë apo korsarë, por kjo është krejt normale. Që në kohën e lashtësisë akuzat për pirateri e korsari në det ishin justifikime të vazhdueshme normale për të fshehur ose minimizuar aksionet grabitqare të akuzuesve. Siç e thekson me të drejtë B. Simon, kjo që rëndom e quajmë pirateri osmane në Adriatik, ishte në fakt një mbrojtje e ligjshme e brigjeve osmane nga kërcënimet spanjolle, por jo rrallë ishin venedikasit që i vuanin pasojat. Këtë e ilustronjë raportet e bailiut venedikas në Stamboll, Cavallit, që njoftojnë mbi një incedent të rëndë që ndodhi në Durrës më 27 prill 1559. Pas këtij incidenti, në të cilin galerat venedikase zhvilluan një betejë me anijet korsare të ankorura në port, bejlerbeu i Kajros si kundërpërgjigje urdhëron sekuestrimin në portin e Aleksandrisë të galerës “La Sanuda Contarina”, me pretekstin se pronarët e saj ishin ortakë me proveditorin e flotës venedikase që kishte

<sup>22</sup> Alessio Bombaci, “Nuovi firmani greci di Maometto II,” *Byzantinische Zeitschrift* 1 (1954): 303, 23 shtator 1479.

<sup>23</sup> Mbi ringritjen e fuqive të tjera adriatike si Ankona, Dubrovniku dhe Trieste shih edhe Philippe Braunstein. “À propos de l'Adriatique, entre le XVIe et le XVIIIe siècle,” *Annales. Économies, Sociétés, Civilisations* 26e année, n. 6 (1971): 1270-1278, ku pthekson: “alors que le conflit se situe sur le terrain plus modeste d'une rivalité entre des partenaires qui s'affrontent de longue date; Raguse et Ancône au XVIe siècle, Ancône encore, puis surtout Trieste au XVIIIe siècle, connaissent une fortune qui ne se nourrit pas seulement du recul commercial et politique de Venise.” (f. 1270).

sulmuar anijet në Durrës, Pandolfo Contarinin.<sup>24</sup> Konkretisht, më 6 prill 1559, katër fusta levendësh kishin hyrë në portin e Durrësit së bashku me 6 marciliana venedikase të ngarkuara me vaj nga Pulja të rimorkuara.<sup>25</sup> Më 25 prill, proveditori i flotës, rrugës për në Durrës ku po shkonte për të kërkuar rikthimin e marcilianave, has në tri fusta të korsarit Deve Hoxha në afërsi të Sazanit, të cilat i ndjek deri sa hyjnë në portin e Durrësit. Të nesërmen, një betejë e vërtetë fillon, si pasojë e së cilës galerat venedikase arrijnë të marrin katër nga gjashtë marcilianat, pasi bombardojnë kështjellën.<sup>26</sup> Ky incident për pak sa nuk provokoi një luftë mes Venedikut dhe Portës së Lartë, por aksioni i menjëhershëm diplomatik për qetësimin e situatës dhe situata e brendshme në Stamboll e evituan një gjë të tillë.<sup>27</sup> Ajo që vërejmë nga reagimet e autoriteteve në këtë rast është se zelli i kapitenit venedikas për të ndëshkuar anijet osmane pa dallim, duke i konsideruar si korsare edhe anijet që i has rrugës dhe pa shkaktuar asnjë provokim, interpretohet ndryshe nga autoritetet osmane. Ato anije nga këto autoritete nuk konsiderohen si pirate, dhe për pasojë sulmi që venedikasit u bëjnë ndërkohë që i hasin kur po shkonin për të marrë marcilianat e tyre në Durrës, për pak sa nuk nis një konflikt detar mes flotave respektive. Të ndodhur para një gabimi juridik dhe para mundësisë së një konflikti, venedikasit e pranojnë tejkalimin e kufijve të vendosur mes palëve dhe vendosin të paguajnë 15 mijë zekinë ryshfet për të shuar shkëndijën e konfliktit.<sup>28</sup> Ekzistonte edhe ana tjetër e medaljes, pra korsaria dhe pirateria venedikase

<sup>24</sup> ASV, Senato Secreta (SS), Archivio Proprio Costantinopoli. Dispaccio n° 32, f° 79, 23 tetor 1558. Bruno Simon, "Contribution à l'étude du commerce vénitien dans l'Empire Ottoman au milieu du XVIe siècle (1558-1560)", *Mélanges de l'Ecole française de Rome. Moyen-Age, Temps modernes* t. 96, n°2 (1984): 973-1020.

<sup>25</sup> ASV, SS, Deliberazioni Costantinopoli 1, f° 112v-113r, 27 prill 1559.

<sup>26</sup> ASV, Collegio pendette 2 (1559-62), f° 11, 27 prill 1559, dispaccio i proveditorit Contarini.

<sup>27</sup> ASV, SS deliberazioni, reg. 71, f°97, 8 maj 1559. Udhëzim për Cavallin që të dorëzojë në mënyrë sekrete tek Kryeveziri një shumë deri në 15 000 zekinë ari. B. Simon, "Contribution à l'étude du commerce vénitien," 1009-1010.

<sup>28</sup> Një situatë e ngjashme e krijuar si pasojë e fundosjes së 16 anijeve osmane të Ali Piceninos në portin e Vlorës në 1638, do të mbyllet me rryshfete të majme. Kenneth M. Setton, *Venice, Venice, Austria, and the Turks in the Seventeenth Century* (Philadelphia: The American Philosophical Society, 1991), 109-110.

e mosrespektimi i marrëveshjeve nga ana e tyre. Kështu, në vitin 1583, kryeadmirali osman, italianii Uluxh Alii propozoi kryevezirit Sijavus Pasha që Kreta u duhej marrë venedikasve, të cilët mbanin një numër të madh galesh të armatosura aty. Për më tepër, ishulli shërbente si strehim për korsarët e krishterë që bastisnin dhe sulmonin brigjet dhe anijet osmane. Sipas kryeadmiralit osman venedikasit mbanin 600 skllëvër osmanë në galerat e tyre në kundërshtim me marrëveshjet.<sup>29</sup>

Si përfundim, mund të thuhet se edhe pse deti dhe historia detare kanë tërhequr një vëmendje shumë të paktë nga historiografia shqiptare, ndërveprimi i shqiptarëve me detin Mesdhe dhe botën mesdhetare është dokumentuar në një shkallë që është e krahasueshme me atë të popujve të tjerë që kanë ndarë historinë e këtij deti të madh. Kjo histori përbën një nga argumentet më të rëndësishme që kanë të bëjnë jo vetëm me lashtësinë e shqiptarëve në trojet e tyre, por njëkohësisht edhe me çështjen e përkatësisë identitare të shqiptarëve. Në thelb, ndërveprimi i shqiptarëve me qytetërimin evropian është që në zanafillë ndërveprim me detin Mesdhe. Ajo që mund të thuhet përciptazi është se në këtë “harresë” përveç arsyeve ideologjike dhe metodologjisë së paqartë,<sup>30</sup> duhet të ketë peshuar edhe fakti se për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore kanë qenë përcaktuar një sërë temash prioritare kryesisht me karakter përgjithësues dhe historia detare si një nënfushë e studimeve historike ka ngërthyer një karakter specifik. Është e dukshme që roli i shqiptarëve në historinë detare të Adriatikut, Jonit, Mesdheut e përtej, bëhet më i madh që nga shekulli XVI dhe ky rol vazhdon të forcohet përgjatë tre shekujve në vazhdim, deri në fillimin e shek. XIX. Ideologjizimi ka rezultuar në një boomerang, pikësëpari duke e mohuar konceptin e agjencisë njerëzore, thënë ndryshe duke e shpërfilluar tërësisht rolin dhe ndikimin e shtresave të gjera të popullsisë nëzhvillimin historik dhe nënatyrën e masën e ushtrimit

---

<sup>29</sup> ASV, SDC, fil. 18, c. 204r, 29 nëntor 1583; Emrah S. Gurkan, “Fooling the Sultan: Information, Decision-Making and the “Mediterranean Faction” (1585-1587),” *Osmanli Arastirmalari/ The Journal of Ottoman Studies* 45 (2015): 57-96. f. 83.

<sup>30</sup> Shih mbi këtë aspekt: Dritan Egro, *Historia dhe ideologjia* (Tiranë: Instituti i Historisë, 2007); Enis Sulstarova, *Arratisje nga lindja* (Tiranë: Pika pa sipërfaqe, 2013); Doan Dani, *Shpikja e Mesjetës. Vetja dhe Tjetri në medievistikën shqiptar*, (Tiranë: Pika pa sipërfaqe, 2016).

të pushtetit. Dekadat e fundit, historiografia botërore i ka kushtuar vëmendje gjithnjë e më të madhe ndërveprimit të superstrukturave sociale dhe vetë indit social, duke e tejkalluar qëndrimin elitari dhe superstrukturalist tradicional që e zhvesh indin social ose shtresën e gjerë të popullsisë nga roli historik, duke e parë vetëm si pësuese dhe jo si ndërvepruese. Paraqitja e rolit të shtresave të gjera në histori vetëm përmes episodeve të shkëputura në kohë e në hapësirë të kryengritjeve kundër superstrukturës politike e ka deformuar më shumë se sa e ka ndriçuar aftësinë e indit social për të ushtruar rolin e vet në histori, vazhdimisht në çdo vend e në çdo kohë. Nga kjo pikëpamje që përjashton agjencinë e indit social në historibërje, periudha osmane është parë thjesht si osmane, si një bllok pa thyerje, pa kundërvënie, zhveshur nga dialektika historike.

Nga ana tjetër, ky qëndrim ideologjik, përveç neglizhimit të rolit dhe veprimit të indit social në historibërje, ka shërbyer edhe si vetëkufizim metodologjik, duke penguar mundësinë e qasjes krahasimtare në aspektin sinkronik dhe diakronik, pra krahasimit të vendeve të ndryshme në kohë të njëjtë dhe në kohë të ndryshme, apo edhe të të njëjtit vend në kohë të ndryshme. Nga llogorja e ideologjisë që përjashton rolin e indit social në historibërje krahasimi është i pamundur, pasi në bazën e çfarëdo krahasimi qëndron njohja e ekzistencës së dukurisë për t'u krahasuar. Nëse roli i indit social në historibërje nuk ekziston, atëherë nuk mund të ekzistojë ndonjë krahasim i tij në kohë as në hapësirë.

Në aspektin krahasimtar shekulli XVI nuk është vetëm shekulli i artë i osmanëve, dhe shekulli i zgjimit të energjive qytetëruese të shqiptarëve, por është shekulli i artë i spanjollëve, i portugezëve, i algjerianëve, i venedikasve, i raguzanëve, i francezëve, të rilindur nga gërmadhat e luftës njëqindvjeçare, pra është shekulli i artë i Mesdheut. Pjesëmarrja dhe përfshirja e shqiptarëve në këtë zgjim qytetëruar mesdhetar, në këtë rilindje të Mesdheut nuk është as e turpshme as e panatyrshme. Është pasojë e pritshme dhe e natyrshme e një trendi gjithëpërfshirës panmesdhetar.